“Shpejtoni në kryerjen e veprave të mira para se të vijnë sprova si copëzat e natës së errët

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Shpejtoni në kryerjen e veprave të mira para se të vijnë sprova si copëzat e natës së errët, në atë kohë njeriu do të gdhihet besimtar, e do të ngryset jobesimtar, ose do të ngryset besimtar e do të gdhihet jobesimtar: e shet fenë për një interes të dynjasë.”

[Sahih] [Transmeton Muslimi]

Profeti në këtë hadith e nxit besimtarin që të shpejtojë dhe të bëjë sa më shumë vepra të mira para se ato të bëhen të pamundura për shkak të preokupimit me shfaqjen e sprovave dhe dyshimeve që e pengojnë besimtarin nga kryerja e punëve të mira. Këto sprova janë si errësira e natës, në të cilën e vërteta përzihet me të kotën dhe për rrjedhojë bëhet e vështirë për njerëzit të bëjnë dallimin mes tyre. Ato janë aq të rënda saqë njeriu çoroditet deri në atë pikë sa në mëngjes është besimtar e në mbrëmje bëhet jobesimtar, si dhe në mbrëmje është besimtar, ndërsa në mëngjes bëhet jobesimtar, duke e braktisur fenë e tij për shkak të kënaqësive kalimtare të kësaj dynjaje.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/3138